



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



RTK 1
Mentor SHALA
Drejtor
Prishtinë

Ankesa Nr. 2016/106 KPM vs RTK 1
Ref:1611/1337/KPM/am

VENDIM

**Lidhur me Ankesën nr. 2016/106 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër RTK 1
("Pala Përgjegjëse")**

Faktet

1. Pala Përgjegjëse është televizion publik me seli në Prishtinë. Pala Përgjegjëse është pajisur me licencë të KPM-së me datën 28 gusht 2009. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës, obligon të Palën Përgjegjëse që të veprojë në përputhje me Ligjin e KPM-së dhe me të gjitha aktet nënligjore të miratuara nga KPM.
2. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës për ofruesit e shërbimeve mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
3. KPM me datën 7 shtator 2017 ka pranuar një ankesë nga z. Gani Bajraktari ndaj Palës Përgjegjëse, për një kronikë të transmetuar në edicionin e lajmeve të orës 19:30 në datën 18 gusht 2017, përmes së cilës z. Bajraktari pretendon se Pala Përgjegjëse në kronikën e lajmeve ka lansuar të pavërteta në lidhje me saktësinë e diplomave të dy specializimeve të tij, duke dëmtuar ndjeshëm imazhin e tij në publik, përpara kolegëve e studentëve, pacientëve dhe miqve, duke i shkaktuar edhe stres psikik dhe dëmtim material. Po ashtu në ankesë theksohet se Pala Përgjegjëse nuk i është drejtuar me asnjë pyetje lidhur me çështjen e ngritur.
4. KPM me datën 8 shtator 2017 nëpërmes një shkrese e ka njoftuar Palën Përgjegjëse për ankesën e pranuar nga z. Bajraktari dhe e ka udhëzuar që brenda pesë ditësh të ofrojë një sqarim lidhur me të.
5. KPM me datën 13 shtator 2017 ka pranuar një përgjigje nga Pala Përgjegjëse, përmes së cilës pretendon se *"RTK 1 mision parësor ka informimin e qytetarëve. Në rastin konkret, fenomeni i mësimdhënies me specializime të kontestuara është çështje e preokupimit të*

ligjshëm publik, kështu që është më se e nevojshme të raportohet për të. RTK 1, gjatë transmetimit të edicionit të Lajmeve Qendrore të datës 18.8.2017, deklaroi se ka lansuar lajme të vërteta, pa shtrembërime, të argumentuara me prova të pakontestueshme...” Po ashtu, në përgjigje të Palës Përgjegjëse thuhet që pretendimi i z. Bajraktari që nuk është kontaktuar nuk ekziston, pasi që ata kanë dëshmi që e kanë kontaktuar.

6. KPM, ka analizuar ankesën e z. Bajraktari, përgjigjen e Palës Përgjegjëse, ka bërë monitorimin e kronikës ndaj së cilës është bërë ankesa dhe në bazë të raportit të monitorimit të datës 25 shtator 2017, KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 2 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, duke mos siguruar mbulim të balancuar të palëve të përfshira.
7. KPM pas të gjeturave nga raporti i monitorimit me datën 5 tetor 2017 me anë të e-mail-it i është drejtuar z. Bajraktarit të cilin e ka udhëzuar që në bazë të nenit 10, paragrafi 2 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, të kërkojë nga Pala Përgjegjëse të drejtën për demant, për korrigjimin e asaj që konsideron që është e pasaktë.
8. Z. Bajraktari me datën 8 tetor 2017 e ka bërë një kërkesë të tillë te Pala Përgjegjëse duke kërkuar që Pala Përgjegjëse të distancohet nga ky lajm i pavërtetë i lansuar kundër tij dhe t'i kërkojë falje publike.
9. KPM pas të gjeturave nga raporti i monitorimit dhe konstatimit se Pala Përgjegjëse nuk e ka publikuar reagimin e z. Bajraktari, me datën 2 nëntor 2017 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për Shkelje, duke e njoftuar për shkeljet e bëra dhe duke kërkuar të veprojë në pajtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03, duke i ofruar menjëherë z. Bajraktari të drejtën për reagim.
10. KPM me datën 13 nëntor 2017 ka pranuar përgjigje nga Pala Përgjegjëse pas Njoftimit për Shkelje, në të cilën sërish i kundërshton shkeljet e gjetura nga KPM, duke mos i quajtur si të tilla dhe duke theksuar se: *“Në rastin konkret nuk ka shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 dhe si rrjedhojë e kësaj, ne assesi nuk duhet të obligohemi nga KPM që t'i mundësojmë palës ankuese të ushtrijë të drejtën e reagimit.”*

Analiza Ligjore

11. Komisioni i KPM-së bazuar në faktet e lartpërmendura konkludon se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 6, paragrafi 2 dhe nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Neni 6, paragrafi 2, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03, përcakton se:

“OSHM-të duhet të sigurojnë një mbulim të balancuar të çështjeve me interes publik dhe çështjeve të kundërthënieve politike dhe të sigurojnë një paraqitje pluralistike të pikëpamjeve, pa asnjë privilegj për ndonjë parti politike, këndvështrim politik apo ndonjë grup ose individ.”

Neni 10, paragrafi 1, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03, përcakton se:

“Me qëllim të korrektësisë dhe paanshmërisë duhet të ofrohet mundësia që brenda shtatë (7) ditësh pas paraqitjes së ankesës së individit apo organizatës, të transmetohet reagimi përkatës në mediumin e njëjtë. Reagimi duhet të transmetohet në kohë dhe hapësirë të njëjtë.”

Neni 10, paragrafi 2, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03, përcakton se:

“Çdo person, pa dallim shtetësie ose vendbanimi, që përmendet në një ofrues të shërbimit medial për të cilin faktet janë bërë të disponueshme për publikun të cilat ai i deklaron që janë të pasakta, mund të ushtrojë të drejtën e reagimit për të korrigjuar faktet që shqetësojnë atë person.”


12. Komisioni i KPM-së pas analizimit të ankesës së z. Bajraktari, raportit të monitorimit dhe përgjigjeve të Palës Përgjegjëse ka gjetur se Pala Përgjegjëse nuk ia ka dhënë të drejtën e demantit z. Bajraktari as pas kërkesës së tij, e as pas Njoftimit për Shkelje të dërguar nga KPM në të cilin i është kërkuar që menjëherë t’ia japë të drejtën për reagim z. Bajraktari.
13. Komisioni i KPM-së duke u bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura gjen se Pala Përgjegjëse ka dështuar që të marrë hapa të nevojshëm për të ardhur në pajtueshmëri dhe ka bërë shkelje të vazhdueshme të nenit 6, paragrafi 2 dhe nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Vendimi

14. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura **kërkon** nga RTK 1 që në afat prej (7) ditësh të transmetojë reagimin e z. Bajraktari, ashtu siç përcaktohet me nenin 10, paragrafi 2, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
15. Komisioni, bazuar në nenin 30 paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, merr vendim që Ofruesi i Shërbimit Medial Audiovizual RTK 1, të sanksionohet me **Vërejtje**, për shkelje të nenit 6, paragrafi 2, dhe nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

E drejta për Ankesë

16. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
17. Bordi për Ankesa do t’i merr parasysht vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Adnan MEROVCI
Kryetar

22.11.2017
datë